

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNIT-t DURRES

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Rajonale ALUIZNI Durres**, me objekt: *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.9.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 34, datë 14.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 805/21, datë 16.04.2014, i ka rekomanduar z. Flamur Gjuzi Drejtor i ALUIZNI Durres, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa për derdhjen e vlerës 38,618,501 lekë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës, nga e cila për tatim taksa 9,843,179 lekë, për sigurimet shoqërore për vlerën 26,071,732 lekë dhe për sigurimet shëndetësore për vlerën 2,700,000 lekë.

Brenda muajit Qershor 2014

2. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore nga njësitë e qeverisjes vendore Qarku Durrës, dorëzimi i 23369 dosjeve të pa arkivuara, në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, të ndryshuar.

Brenda muajit Qershor 2014

3. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës, të rakordohet dhe të plotësohet sistemi digjital me vetëdeklarimet e pahedhura nga sistemi manual për 1329 raste (dosje), si dhe në bazë të dokumentacionit që disponohet dhe të korrespondencës me NJ.Q.V, institucionet dhe subjekte të ndryshëm, të bëhet azhurnimi i studimeve urbanistike pjesore në zbatim të procesit të legalizimit.

Brenda muajt Qershor 2014

4. Për të gjitha praktikat të përcaktohet në gen plan, hyrja në parcelën ndërtimore, në çdo dosje të vendosen ortofotot digjitale dhe relacioni tekniko-ligjor, në zbatim të nenin 32 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”* dhe të pikës 1.3, të urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 *“Për miratimin e manualit “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të objektit që legalizohet”*.

Vazhdimisht

5. Në dosjen nr. 2449, datë 07.09.2006, për pasurinë nr. 1/646 dhe dosjen nr. 3224, datë 15.03.2005, për pasurinë nr. 17/257, të vendosen në genplanet përkatëse, kufizimet në veri dhe në perëndim në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, të ndryshuar, të ndryshuar.

Brenda muajt Qershor 2014

6. T'i kërkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet e pajisura me leje legalizimi në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, për shfuqizimin e lejeve të legalizimit sipas pasqyrës në Raportin e Auditimit.

Brenda muajt Maj 2014

7. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës, të hartoj rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit duke ndarë detyrat për çdo sektor dhe për punonjës, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, VKM nr. 289, datë 17.05.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/ndërtimeve informale (ALUIZNI), të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 82, datë 03.05.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së degëve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe integritit të Zonave/ndërtimeve Informale".

Brenda muajt Qershor 2014

8. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës, të nxirret urdhri i brendshëm për kryerjen e inventarizimit të gjithë dosjeve dhe dokumentacionit që administrohet në to, të vendoset detyrimisht numri i çdo dokumenti sipas radhës në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", neni 24, germa "b" dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për "Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror" dhe "Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore" detyrë që pasur parasysht vazhdimisht.

Brenda muajt Maj 2014

9. Nga Drejtori i Aluiznit Durrës, të merren masa që në formularin e pagesës të nënshkruajnë edhe përgjegjësi i sektorit të legalizimit duke përcaktuar saktësisht jo vetëm zonën por edhe çmimin për m² të parcelës ndërtimore që do të aplikohet.

Vazhdimisht

10. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Durrës të marrë masa, për të bashkëngjitur parcelave ndërtimore sipërfaqet e poseduara por të pa llogaritura për pagesë, në **8 rastet** e evidentuara në Projektraportin e Auditimit të KLSH, me sipërfaqe totale 1898 m² llogaritur në vlerën **15,609,088 lekë, pasi** është e pamundur të konfigurohen parcela të veçanta ndërtimore, të bashkëpunohet me njësitë e qeverisjes vendore dhe ZVRPP-në në terren, dhe të veprohet sipas kërkesave të nenit 17, pika 1, të ligjit nr, 9482 datë 3.4.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.

Brenda muajt Qershor 2014

11. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Durrës të marrë masat përkatëse për të mos lejuar zvogëlimin e sipërfaqeve të parcelave ndërtimore në zonat formale dhe informale (Brenda dhe jashtë vijës së verdhë), për vijueshmërinë territoriale në kufij dhe kufizime të parcelave dhe moskrijimin e sipërfaqeve të ndërmjetme mes tyre me regjim juridik të ndryshëm (troje, tokë arë, pyll, etj..) në përputhje me nenin 17, pika 1 të ligjit për legalizimin dhe me përcaktimet në pikën 1 paragrafi i parë me nënpikat 1.1, 1.2 dhe 1.3, paragrafi i dytë dhe i katërt të Manualit "*Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (gentplan, ortofoto, planimetri) të objektit që legalizohet*", të miratuar me urdhërin nr. 291, datë 1.9.2008, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t".

Vazhdimisht

12. Të kërkohet studimi urbanistik pjesor i Zonës 13 E/D miratuar me vendimin e KRRTRSH nr. 16, datë 14.7.2009 i zbardhur për pasurinë nr. 147/123, Zona Kadastrale nr.

1522 legalizuar në favor të qytetarit S.M. banues në fshatin Ishëm - në sipërfaqe parcele 631 m² me zërin kadastral “ARË” sipërfaqe ndërtimi 80 m² (baza e ndërtimit) për banim 1 kat ndërtuar në vitin 2000.

Brenda muajt Qershor 2014

13. Në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe ZVRPP Durrës për vendstrehimin në Pasurinë nr. 5/269, Zona Kadastrale nr. 8513, Adresa: L. 17, sipërfaqe parcele 300 m², i cili bën pjesë në asetet e Bashkisë Durrës mbi të cilin qytetari Y.K. në vitin 1991 ka ndërtuar shtëpi banimi 2 kate, sipërfaqe baze ndërtimi 92 m², të kryhet veprimi i heqjes nga inventari bazuar në dispozitat ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve me karakter mbrojtës.

Brenda muajt Qershor 2014

14. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Durrës të marrë masa, për të evidentuar, kontabilizuar dhe ndjekur në të gjitha rrugët ligjore arkëtimin e detyrimeve të efekteve financiare që rjedhin nga diferenca e çmimit të truallit të legalizuar, nga ato që kanë përfituar pas datës 27 Mars 2013, si rezultat i interpretimit të gabuar të pikës 2 germa “c” të kërkesave të VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha Bashkitë dhe në disa Komuna” dhe VKM nr. 187, datë 06.03.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë.

Brenda muajt Qershor 2014

15. T’i kërkohet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me nenin 2 dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, pikën 2, germa “a”, “b” dhe “dh”, të VKM^{së} nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, të nenit 29, të ligjit nr. 9048 datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, të neni 2 dhe 3, të VKM^{së} nr. 237, datë 23.03.2011 “Për miratimin e rregullores, për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit, pika 11 e nenit 3, të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për sa më poshtë:

- **22 raste**, në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të Bashkisë Durrës;
- **4 raste**, brenda brezit mbrojtës së hekurudhave;
- **19 raste**, në brenda ose pranë vijës së ndërtimit të strukturës së rrugës dhe kanalet kullues;
- **157 raste**, në Studim Urbanistik të Zonës së Plazhit Durrës (rrugët, lartësitë dhe distancat midis objekteve).

Brenda muajt Qershor 2014

16. Nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimeve, Urbanizimit dhe Interrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Durrës, të merren masa për azhurnimin përfundimtar të objekteve informale (të hedhura ose jo) në hartën vektoriale të kalimit pronësisë, sipas të gjithë elementet e hartës, në përputhje me VKM nr. 397, datë 21.06.2006 “Për miratimin e planveprimit për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” dhe VKM nr. 437, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjes, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, sipas pasqyrës.

Brenda muajt Qershor 2014

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **95,772,232 lekë**, nga **107 ra ste**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Për vlerën 2.017.001 lekë në ngarkim të 10 personave, nga e cila: vlera **366.958 lekë** në ngarkim të punonjës F.Y.; Vlera **335.891** në ngarkim të punonjës Y.H.; Vlera **209.940 lekë** në ngarkim të punonjës I.L.; Vlera **271.004 lekë** në ngarkim të punonjës O.M.; Vlera **256.025 lekë** në ngarkim të punonjës M.K.; Vlera **125.472 lekë** në ngarkim të punonjës H.H.; Vlera **126.467 lekë** në ngarkim të punonjës E.GJ.; Vlera **125.862 lekë** në ngarkim të punonjës M.S.; Vlera **119.427 lekë** në ngarkim të punonjës Petrit Ismailiati; Vlera **79.955 lekë** në ngarkim të punonjës A.K.; për paga të dhëna në kundërshtim me kërkesat e shkresës së MF nr. 74/23, datë 16.02.2011, shkresën nr.109/4, datë 13.02.2012 të MPPT, dhe të shkresës nr. 149/34, datë 01.03.2013 të MF.

Brenda muajit Qershor 2014

2. Për vlerën 40.000 lekë, në ngarkim të punonjës A.L., ish Drejtor i ALUIZNI për vitin 2011 për përballim të shpenzimeve të telefonisë celulare në kundërshtim me 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefoninë celulare të personave juridik dhe publik”.

Brenda muajit Qershor 2014

3. Për vlerën 604.022 lekë, në ngarkim të 3 punonjësve nga e cila vlera 352.579 lekë në ngarkim të punonjës A.SH., vlera 234.948 lekë në ngarkim të punonjës E.M., vlera 16.495 lekë në ngarkim të punonjës I.D. për mosargumentim të shpenzimeve për karburant nëpërmjet transaksioneve të kryera në kundërshtim me nenet 8, 9, e 10 të Kreut II-të, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe të nenit 15, 35, 36, 42 e 43, të UMN nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Brenda muajit Qershor 2014

4. L.M., Lagjia nr.14, Shkozë, Durrës, ZK 8516, pasuria nr. 18/78 **për vlerën 402.841 lekë** si rezultat i aplikimit të vlerës së parcelës ndërtimore prej 97 m² për banim, në kundërshtim me VKM nr.1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndeshen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna” dhe VKM nr. 139, datë 13.02.2008, ku është përcaktuar miratimi i çmimeve të trojeve në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit e Shkodrës.

Brenda muajit Qershor 2014

5. I.N., Lagjia 17, Rruga Dëshmorët, ZK nr.8513, pasuria nr. 5/726, **për vlerën 2.374.157 lekë** si rezultat i aplikimit të vlerës së parcelës ndërtimore prej 314m² për aktivitet social, në kundërshtim me VKM nr.1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndeshen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna” dhe VKM nr. 139, datë 13.02.2008, ku është përcaktuar miratimi i çmimeve të trojeve në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit e Shkodrës.

Brenda muajit Qershor 2014

6. P.D. Lagja 18 ZK 8511, pasuria nr. 28/195 volumi 41, faqe 199 në vlerën **204,013 lekë** nga të cilat 203 mijë lekë diferencë çmimi për m² dhe 1 mijë lekë diferencë taksë ndikimi në infrastrukturë pasi sipas pikës 5 të VKM nr. 870, datë 27.12.2006, **llogaritja për vlerën e shtuar të** sipërfaqes së parcelës ndërtimore për aktivitet social ekonomik prej 134,80 m² nuk është kryer sipas kritereve të përcaktuara pasi vlera shtesë e trullit llogaritet mbi

sipërfaqen për aktivitet prej 134,80 m² x çmimin e shitjes 1,887 lekë/m² baras 254,368 lekë x koeficientin 0,80 (1- 0,20) baras **203,494 lekë**.

Nga llogaritja e vlerës së plotë të parcelës ndërtimore për banim dhe aktivitet që duhej paguar 132 m² gjithsej baras 421,585 lekë + 203,494 lekë baras 625,079 lekë gjithsej nga e cila zbresim vlerën e paguar 421,585 lekë **baras 203,494 lekë paguar më pak**.

Bazuar në Udhëzimin nr. 1, datë 8.5.2013 të EKB kosto mesatare e ndërtimit për vitin 2013 për Durrësin është 29,887 lekë/m² pra duhej llogaritur dhe paguar sip. ndërtimit 674 m² x 29,887 lekë x 0,5% baras 100,719 lekë ose **paguar më pak 519 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2014

7. F.H. Lagja 13 ZK 8518, pasuria nr. 2/96 volumi 2, faqe 48 në vlerën **3,080 lekë** nga të cilat 3,043 mijë lekë diferencë çmimi për m² pasi për tejkalim afati të vetëdeklarimit janë aplikuar sanksione 20 lekë/ m² ose për 26 m² sipërfaqe toke të zënë në vlerën 520 lekë kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 kjo gjobë duhej aplikuar për 180 m² sipërfaqe toke e zënë x 20 lekë në vlerën 3,600 lekë ose **paguar më pak 3,080 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2014

8. R.D. ZK 3852 Komuna Xhafzotaj për pasurinë nr. 401/10, vol.27, faqe 114-120, në vlerën **10,126 lekë** pasi për tejkalim afati të vetëdeklarimit nuk janë aplikuar sanksione 20 lekë/ m² kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 kjo gjobë duhej aplikuar për 500 m² sipërfaqe toke x 20 lekë m² baras në vlerën 10,000 lekë ose **paguar më pak 10,126 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2014

9. H.G. ZK 3339 Komuna Rrashbull për pasurinë nr. 30/13, vol.1, faqe 124, në vlerën **5,138 lekë** pasi bazuar për tejkalim afati të vetëdeklarimit nuk janë aplikuar sanksione 10 lekë/ m² kur sipas pikës “a” të nenit 8 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 kjo gjobë duhej aplikuar për 500 m² sipërfaqe toke x 10 lekë në vlerën 5,000 lekë ose **paguar më pak 5,138 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2014

10. A.L. ZK 1031 Komuna Rrashbull për pasurinë nr.229/69, vol.11, faqe 242, në vlerën **2,082 lekë** pasi bazuar në Udhëzimin nr.1, datë 8.5.2013 të EKB kosto mestare e ndërtimit për vitin 2013 për Durrësin është 29,887 lekë/m² pra duhej llogaritur dhe paguar sip. ndërtimit 988 m² x 29,887 lekë x 0,5% baras 147,642 lekë ose **paguar më pak 2,082 lekë**.

Brenda muajit Qershor 2014

11. Q.C. ZK 8511 Lagja 15 për pasurinë nr.2/99, vol.2, faqe 190, në vlerën **43,529 lekë** pasi nga llogaritja e vlerës shtesë të parcelës ndërtimore për aktivitet rezulton se 36 m² x 1,703 lekë m² x koeficientin 0,71 (K 1-0,29) baras **43,529 lekë** paguar më pak e cila përbën dëm ekonomik.

Brenda muajit Qershor 2014

12. B.H. ZK 8515 Lagja 14 për pasurinë nr.3/183, vol.1, faqe 180, në vlerën **3,000 lekë** pasi pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 297 m² është përcaktuar në vlerën 397,000 lekë dhe jo në vlerën 400,000 lekë sikurse përcaktohet në germën “c” neni 20 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”* ose paguar **3,000 lekë më pak**.

Brenda muajit Qershor 2014

13. M.F. ZK 8511 Lagja 15 për pasurinë nr.24/29, vol.2, faqe 189, në vlerën **1,626,638 lekë** pasi pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 429 m² është përcaktuar në vlerën 1,096,600 lekë, prej të cilave shuma 471,600 në lekë dhe shuma 625,000 lekë në bono privatizimi kur sipas Zonës 3 dhe listës të përcaktuar me VKM nr.139, datë 13.2.2008 i pa ndryshuar edhe me VKM nr.1620, datë 26.11.2008 *“Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha Bashkitë dhe në disa Komuna”* ku çmimi i tregut për

truallin duhej llogaritur 18,000 lekë/m² ose 300 m² baras 400,000 lekë ndërsa 129 m² x 18,000 lekë baras 2,322,000 lekë ose gjithsej në vlerën 2,722,000 lekë llogaritur dhe duke zbritur vlerën e paguar 1,096,600 lekë **diferenca paguar më pak 1,625,400 lekë.**

-Për sipërfaqen e ndërtimit dhe vlerën e investimit prej 129 m² x 29,108 lekë x 1% taksa e ndikimit në infrastrukturë është përcaktuar në vlerën 37,550 lekë kur duhej llogaritur me koston mesatare të ndërtimit 29,714 lekë baras me vlerën 38,331 lekë ose **diferenca paguar më pak 781 lekë.**

- Për tejkalim afati të vetëdeklarimit janë aplikuar sanksione në masën 25% të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë 37,550 lekë ose në vlerën 9,388 lekë kur sipas pikës b të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 duhej llogaritur mbi vlerën 38,331 lekë ose në vlerën 9,845 lekë ose **diferenca paguar më pak 457 lekë.**

Brenda muajit Qershor 2014

14. S.B. ZK 8511 Lagja 15 për pasurinë nr.12/120, vol.2, faqe 185, në vlerën **430,157 lekë** pasi pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 326 m² është përcaktuar në vlerën 493,600 lekë, prej të cilave shuma 168,600 në lekë dhe shuma 325,000 lekë në bono privatizimi kur sipas Zonës 3 dhe listës të përcaktuar me VKM nr.139, datë 13.2.2008 i pa ndryshuar edhe me VKM nr.1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha Bashkitë dhe në disa Komuna” ku çmimi i tregut për truallin duhej llogaritur 18,000 lekë/m² ose 300 m² baras 400,000 lekë ndërsa 26 m² x 18,000 lekë baras 468,000 lekë ose gjithsej në vlerën 868,000 lekë llogaritur dhe paguar vlera 439,600 lekë **diferenca paguar më pak 428,400 lekë.**

-Për sipërfaqen e ndërtimit dhe vlerën e investimit prej 121 m² x 29,108 lekë x 1% taksa e ndikimit në infrastrukturë është përcaktuar në vlerën 35,220 lekë kur duhej llogaritur me koston mesatare të ndërtimit 29,714 lekë baras me vlerën 35,954 lekë ose **diferenca paguar më pak 734 lekë.**

- Për tejkalim afati të vetëdeklarimit janë aplikuar sanksione në masën 25% të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë 35,220 lekë ose në vlerën 8,805 lekë kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 duhej llogaritur mbi vlerën 35,954 lekë ose në vlerën 8,988 lekë ose **diferenca paguar më pak 183 lekë.**

- Përveç sa sipër për tejkalim afati të vetëdeklarimit janë aplikuar sanksione në masën 20 lekë/m² ose në vlerën 3,260 lekë kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 duhej llogaritur në vlerën 4,100 lekë ose **diferenca paguar më pak 840 lekë.**

Brenda muajit Qershor 2014

15. TH.DH. ZK 8515 Lagja 14 për pasurinë nr.2/841, vol.1, faqe 179, në vlerën **10,000 lekë** pasi për tejkalim afati të vetëdeklarimit nuk janë aplikuar sanksione kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 duhej aplikuar në masën 20 lekë/m² ose paguar **10,000 lekë më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

16. A. H. ZK 8515 Lagja 14 për pasurinë nr.2/837, vol.1, faqe 178, në vlerën **10,000 lekë** pasi për tejkalim afati të vetëdeklarimit nuk janë aplikuar sanksione kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 duhej aplikuar në masën 20 lekë/m² ose paguar **10,000 lekë më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

17. F.S. ZK 8517 Lagja 14 për pasurinë nr.151/102, vol.1, faqe 131, në vlerën **233,596 lekë** pasi pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 332 m² është përcaktuar në vlerën 515,200 lekë, prej të cilave shuma 180,200 në lekë dhe shuma 335,000 lekë në bono privatizimi, kur sipas kriterëve ligjore duhej llogaritur sipërfaqja deri 300 m² baras 400,000 lekë + 32 m² me çmimin e tregut x 10,800 lekë/m² ose gjithsej në vlerën 745,600 lekë ose

duke zbritur vlerën e paguar 515,200 lekë se rezulton se Festim Sorra paguar **230,400 lekë më pak.**

Pagesa për sipërfaqen e ndërtimit dhe vlerën e investimit prej 51,57 m² x 29,108 lekë x 1% taksa e ndikimit në infrastrukturë është llogaritur në vlerën 15,011 lekë kur duhej llogaritur 51,57 m² x 29,714 në vlerën 15,324 lekë ose paguar **311 lekë më pak.**

Për tejkalim afati të vetëdeklarimit nuk janë aplikuar sanksione kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 duhej aplikuar në masën 20 lekë/m² në vlerën 6,640 lekë dhe jo 25% të vlerës së taksës në infrastrukturë 3,755 lekë ose paguar **2,885 lekë më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

18. J.M. ZK 8511 Lagja 18 për pasurinë nr.19/86, vol.2, faqe 186, në vlerën **2,908,800 lekë** pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore objekt i dytë prej 202 m² është përcaktuar në vlerën 727,200 lekë, ku çmimi i tregut për truallin duhej llogaritur 202 m² x 18,000 lekë/m² baras 3,636,000 lekë në një kohë kur është llogaritur dhe paguar vlera 727,200 lekë ose (vlera që duhej paguar 3,636,000 lekë – 727,200 lekë vlera e paguar në fakt) **diferenca paguar më pak 2,908,800 lekë.**

Brenda muajit Qershor 2014

19. R.L. Lagja 13 ZK 8518, pasuria nr.40/77 volumni 2, faqe 47 në vlerën **3,043,000 lekë** nga të cilat 3,043 mijë lekë diferencë çmimi për m² pasi sipas nenit 20 germa “c” dhe “ç” të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 479 m² është paguar vlera 2,727,000 lekë kur duhej paguar 300 m² sipërfaqe ndërtimore në vlerën 400,000 lekë dhe 179 m² sipërfaqe ndërtimore x 30,000 lekë m² baras në vlerën 5,370,000 lekë ose gjithsej 479 m² sipërfaqe ndërtimore (400,000 lekë + 5,370,000 lekë) në vlerën 5,770,000 lekë. Diferenca nga 5,770,000 lekë që duhej paguar – 2,727,000 lekë e paguar në fakt baras **3,043,000 lekë paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

20. I. N. Lagja 13 ZK 8518, pasuria nr.28/195 volumni 2, faqe 59 në vlerën **3,505,450 lekë** nga të cilat 3,502 mijë lekë diferencë çmimi për m² pasi përlllogaritja e sipërfaqes së parcelës ndërtimore është bërë me çmimin 12.000 lekë për m² bazuar në hartën e vlerës për ZK 8518 të qytetit Durrës 2012 mbështetur në VKM nr.658, datë 26.9.2012 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësim e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr.187, datë 6.3.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë” botuar në Fletoren Zyrtare nr.42, datë 27.3.2013 i cili është aplikuar duke ndryshuar çmimin në listën nr.1 të VKM nr.1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha Bashkitë dhe në disa Komuna” Zona 7 dhe 7,1 Plazh Hekurudha Durrës ku çmimi ka qënë 30,000 lekë për m².

Sipas germa “c” dhe “ç” të nenit 20 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, për sipërfaqen e parcelës ndërtimore 506 m² është paguar vlera 3,078,000 lekë kur duhej paguar 300 m² sipërfaqe ndërtimore në vlerën 400,000 lekë dhe 206 m² sipërfaqe ndërtimore x 30,000 lekë m² baras në vlerën 6,180,000 lekë ose gjithsej 506 m² sipërfaqe ndërtimore (400,000 lekë + 6,180,000 lekë) baras në vlerën 6,580,000 lekë. Diferenca nga 6,580,000 lekë që duhej paguar – 3,078,000 lekë paguar në fakt baras **3,502,000 lekë paguar më pak.**

Për tejkalim afati të vetëdeklarimit janë aplikuar sanksione 10 lekë/ m² ose për 161 m² sipërfaqe toke të zënë në vlerën 1,610 lekë kur sipas pikës “b” të nenit 8 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 kjo gjobë duhej aplikuar për 506 m² sipërfaqe toke e zënë x 10 lekë në vlerën 5,060 lekë ose **paguar më pak 3,450 lekë.**

Brenda muajit Qershor 2014

21. B. A. Lagja 13 ZK 8518, pasuria nr.26/140 volumi 2, faqe 34 në vlerën **36,013,594 lekë** si diferencë çmimi për m² pasi përlllogaritja e sipërfaqes së parcelës ndërtimore është bërë me çmimin 12.000 lekë për m² bazuar në hartën e vlerës për ZK 8518 të qytetit Durrës 2012 mbështetur në VKM nr.658, datë 26.9.2012 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësim e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 187, datë 6.3.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 42, datë 27.3.2013 i cili është aplikuar duke ndryshuar çmimin në listën nr.1 të VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha Bashkitë dhe në disa Komuna” Zona 7 dhe 7,1 Plazh Hekurudha Durrës ku çmimi ka qenë 30,000 lekë për m².

Sipas germa “c” dhe “ç” nenit 20 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, duhej llogaritur dhe paguar sipërfaqe ndërtimore 861 m² për parcelën deri 300 m² sipërfaqe ndërtimore në vlerën 400,000 lekë dhe 561 m² sipërfaqe ndërtimore në vlerën e tregut (561 m² x 30,000 lekë) 16,830,000 lekë ose gjithsej banim + aktivitet 861 m² sipërfaqe parcele ndërtimore në vlerën 17,230,000 lekë.

Sipas pikës 5 të VKM nr.870, datë 27.12.2006 **llogaritja për vlerën e shtuar të sipërfaqes së parcelës ndërtimore** prej 726 m² për aktivitet social ekonomik nuk është kryer sipas kriterëve të përcaktuara pasi vlera shtesë e truallit llogaritet mbi sipërfaqen për aktivitet prej 726 m² x çmimin e shitjes 20,012 lekë/m² baras 14,528,712 lekë x koeficientin (1+ 907) baras 27,706,254 lekë.

Llogarisim vlerën e plotë të parcelës ndërtimore për banim dhe aktivitet që duhej paguar 861 m² gjithsej baras 17,230,000 lekë + 27,706,254 lekë baras 44,936,254 lekë gjithsej nga e cila zbresim vlerën e paguar 8,922,660 lekë **baras 36,013,594 lekë paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

22. U.R. ZK 8517 Lagja 14 për pasurinë nr. 151/102, vol.1, faqe 131, në vlerën **80,710 lekë** pasi pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 311,10 m² është përcaktuar në vlerën 439,960 lekë kur duhej llogaritur për sipërfaqen deri 300 m² në vlerën 400,000 lekë dhe për sipërfaqen 11,10 m² x 10,800 lekë baras 119,880 lekë ose 519,880 lekë gjithsej **ose paguar më pak 79,920 lekë.**

-Për sipërfaqen e ndërtimit dhe vlerën e investimit prej 223,18 m² taksa e ndikimit në infrastrukturë është përcaktuar në vlerën 32,367 lekë duke përdorur koston mesatare të vitit 2010 në një kohë që duhej llogaritur sipërfaqe ndërtimi 223,18 m² x 29,714 lekë x 0,5% baras 33,157 lekë ose **790 lekë paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

23. F.N. ZK 8513 Lagja 17 për pasurinë nr. 12/160, vol. 2, faqe 250, në vlerën **979,200 lekë** pasi pagesa për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 436 m² është përcaktuar në vlerën 889,600 lekë dhe jo sikurse përcaktohet në germën “c” neni 20 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” për deri 300 m² në vlerën 400,000 lekë dhe për sip. mbi 300 m² konkretisht për 136 m² me çmimin e tregut x 10,800 lekë m² baras 1,468,800 lekë ose gjithsej për 436 m² në vlerën 400,000 lekë + 1,468,800 lekë baras gjithsej vlera e parcelës ndërtimore që duhej paguar 1,868,800 lekë minus - vlerën e paguar në fakt 889,600 lekë dhe rezulton diferenca në vlerën **979,200 lekë e paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

24. S.F. ZK 8513 Lagja 17 për pasurinë nr. 5/697, vol.3, faqe 57, në vlerën 130,022 lekë pasi sipas pikës 5 të VKM nr. 870, datë 27.12.2006 dhe pikës 4,3 të nenit 4 të VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e të ardhurave të procesit të legalizimit” llogaritja për vlerën e shtuar të

sipërfaqes së parcelës ndërtimore prej 87m² për aktivitet social ekonomik nuk është kryer sipas kritereve të përcaktuara pasi vlera shtesë e truallit llogaritet mbi sipërfaqen për aktivitet prej 87 m² x çmimin e shitjes 2,135 lekë/m² baras 185,745 lekë x koeficientin 0,70 (1- 0,30) baras 130,022 lekë.

Nga llogaritja e vlerës së plotë të parcelës ndërtimore për banim dhe aktivitet që duhej paguar 173 m² gjithsej baras 369,375 lekë + vlerën e shtuar për aktivitet 130,022 lekë baras 499,397 lekë gjithsej nga e cila zbresim vlerën e paguar 369,375 lekë **baras 130,022 lekë paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

25. S.G. ZK 8511 Lagja 18 për pasurinë nr.16/304, vol.1, faqe 42, në vlerën **137,214 lekë** pasi sipas pikës 5 të VKM nr.870, datë 27.12.2006 dhe pikës 4,3 të nenit 4 të VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 *“Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e të ardhurave të procesit të legalizimit”* llogaritja për vlerën e shtuar të sipërfaqes së parcelës ndërtimore për aktivitet social ekonomik prej 132 m² nuk është kryer sipas kritereve të përcaktuara pasi vlera shtesë e truallit llogaritet mbi sipërfaqen për aktivitet prej 132 m² x çmimin e shitjes 1,890 lekë/m² baras 249,480 lekë x koeficientin 0,55 (1- 0,45) baras 137,214 lekë.

Nga llogaritja e vlerës së plotë të parcelës ndërtimore për banim dhe aktivitet që duhej paguar 229,70 m² gjithsej baras 434,166 lekë + vlerën e shtuar për aktivitet 137,214 lekë baras 571,380 lekë gjithsej nga e cila zbresim vlerën e paguar 434,166 lekë **baras 137,214 lekë paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

26. N.P. ZK 8511 Lagja 15 për pasurinë nr.16/304, vol.1, faqe 42, në vlerën **140,699 lekë** pasi sipas pikës 5 të VKM nr.870, datë 27.12.2006 dhe pikës 4,3 të nenit 4 të VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 *“Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e të ardhurave të procesit të legalizimit”* llogaritja për vlerën e shtuar të sipërfaqes së parcelës ndërtimore për aktivitet social ekonomik prej 136 m² nuk është kryer sipas kritereve të përcaktuara pasi vlera shtesë e truallit llogaritet mbi sipërfaqen për aktivitet prej 136 m² x çmimin e shitjes 1,881 lekë/m² baras 255,816 lekë x koeficientin 0,55 (1- 0,45) **baras 140,699 lekë.**

Nga llogaritja e vlerës së plotë të parcelës ndërtimore për banim dhe aktivitet që duhej paguar 235 m² gjithsej baras 442,015 lekë + vlerën e shtuar për aktivitet prej 136 m² 140,699 lekë baras 582,714 lekë gjithsej nga e cila zbresim vlerën e paguar 442,015 lekë **baras 140,699 lekë paguar më pak.**

Brenda muajit Qershor 2014

27. L.S., për vlerën 467.250 pasi në llogaritjen e vlerës së parcelës ndërtimore dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe mos pagesës së tarifës së shërbimit të legalizimit për një kat për vetëdeklarimin nr.511, datë 28.8.2006, nga e cila:

-tarifë shërbimi për një kat vlera 4,000 lekë.

-diferencë çmimi sipërfaqe parcele ndërtimore vlera 459,625 lekë.

-diferencë taksë ndikimi në infrastrukturë vlera 3,625 lekë.

Brenda muajit Qershor 2014

28. Nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimeve, Urbanizimit dhe Interrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale **Durrës**, të merren masa për arkëtimin e vlerës së detyrimit prej **20,460,278 lekë**, nga **24 persona**, ku llogaritja e detyrimeve të tarifës së parcelës ndërtimore të objekteve informale (*banesë dhe të kombinuara*), është bërë në kundërshtim me VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe disa komuna”, VKM nr. 870, datë 27.12.2006 “Për koeficientin e

shfrytëzimit të ndërtesës në legalizim me destinacon ekonomik” dhe VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimit e të ardhurave të procesit të legalizimit”, sipas pasqyrës bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Brenda muajit Qershor 2014

29. Nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimeve, Urbanizimit dhe Interrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Durrës, të merren masa për arkëtimin e vlerës së detyrimit prej **19,745,444 lekë të 19 rasteve**, ku llogaritja e detyrimeve të tarifës së parcelës ndërtimore të objekteve informale, është bërë në kundërshtim me nenit 37, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.....”, i ndryshuar, VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe disa komuna”, pikën 1, 2,5 dhe 6, të VKM nr. 870, datë 27.12.2006, si dhe pika 4,3, të nenit 4, të VKM nr. 1180, datë 5.8.2008, *trajtuar në faqen 146 - 251, të Raport auditimit*, konkretisht pasqyra:

Nr.	Dosja	Leja Legalizimit		Vlera
		Nr.	Data	
1	1075	14734	30.08.2013	76,062
2	9700	84631	02.09.2013	500,584
3	6570	999023	27.08.2013	3,695,000
4	7765	15330	03.09.2013	2,312,000
5	7385	999022	27.08.2013	1,785,000
6	754	97770	04.04.2013	2,441,500
7	7935	15877	04.09.2013	596,602
8	7934	15876	04.09.2013	644,806
9	7936	15878	04.09.2013	854,462
10	9146	13691	29.05.2012	351,600
11	9855	89699	11.09.2013	1,870,000
12	1393	6835	06.06.2011	68,400
13	2489	5974	20.04.2011	1,297,908
14	6254	7872	12.10.2011	972,000
15	7186	5826	15.04.2011	361,800
16	9184	6512	05.05.2011	162,000
17	7627	4709	28.01.2011	474,480
18	6517	4447	05.01.2011	633,240
19	4475	4446	05.01.2011	648,000
Totali i detyrimit				19,745,444

Brenda muajit Qershor 2014

30. Nga Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimeve, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Durrës, të merren masa për arkëtimin e vlerës së gjobës prej **141,191 lekë**, nga **35 persona**, për mos llogaritje të gjobës për deklarim me vonesë në kundërshtim me nenin 7, pika 2, e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin,

urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, *trajtuar në faqen 146 - 148, të Raport auditimit*, sipas pasqyra:

Nr.	Dosja	Data e Vetëdeklarimit	Penaliteti
1.	3916	14.09.2006	1,290
2.	1154	31.08.2006	5,480
3.	3242	11.09.2006	4,190
4.	129	23.08.2006	3,830
5.	2218	06.09.2006	4,160
6.	2826	11.09.2006	4,820
7.	1613	04.09.2006	3,610
8.	2453	07.09.2006	2,690
9.	1986	05.09.2006	3,360
10.	1107	30.08.2006	6,160
11.	2830	11.09.2006	4,630
12.	3364	10.09.2006	3,510
13.	3991	07.09.2006	5,170
14.	1237	31.08.2006	2,000
15.	9686	24.11.2006	10,000
16.	3395	17.08.2006	3,790
17.	2159	05.09.2006	2,380
18.	300	25.08.2006	4,410
19.	2083	05.09.2006	2,810
20.	1807	04.09.2006	3,790
21.	5311	16.10.2006	2,560
22.	1418	01.09.2006	5,000
23.	1288	31.08.2006	830
24.	279	24.08.2006	3,240
25.	4213	14.09.2006	3,000
26.	1783	19.09.2006	4,420
27.	1783/1	19.09.2006	2,800
28.	1783/2	19.09.2006	2,590
29.	3010	11.09.2006	9,560
30.	4146	14.09.2006	5,057
31.	2243	06.09.2006	2,780
32.	1569	06.09.2006	2,000
33.	2791	08.09.2006	4,360
34.	686	29.08.2006	5,000
35.	7189	10.11.2006	5,914
Totali i vlerës së gjobës.....			141,191

Brenda muajit Qershor 2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-it, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

I. Për Drejtorinë Rajonale të ALUZNIT Durrës

I/A “Zgjidhjen e kontratës së punës”

- 1- **Z. A.L.**, me detyrë ish-Drejtor Aluizni Durrës;
- 2- **Z. E.J.**, me detyrë ish-Drejtor Aluizni Durrës;
- 3- **Z. K.K.**, me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim Durrës;
- 4- **Z. P.I.**, me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim Durrës;
- 5- **Znj. A.L.**, me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim Durrës;
- 6- **Z. G.D.**, me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim Durrës;
- 7- **Z. F.C.**, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit Fillestar

a) Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimeve, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin të objektit informal (leje legalizimi), si në;

- **22 raste**, në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të Bashkisë Durrës;
- **4 raste**, brenda brezit mbrojtës së hekurudhave;
- **19 raste**, në brenda ose pranë vijës së ndërtimit të strukturës së rrugës dhe kanalet kullues;
- **156 raste**, në Studim Urbanistik të Zonës së Plazhit Durrës (rrugët, lartësitë dhe distancat midis objekteve);

veprime në kundërshtim me nenin 2 dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, pikën 2, germa “a“, “b“ dhe “dh”, të VKM-së nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, të nenit 29, të ligjit nr. 9048 datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, të neni 2 dhe 3, të VKM-së nr. 237, datë 23.03.2011 “Për miratimin e rregullores, për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit, pika 11 e nenit 3, të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

b) Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen e vlerave të tarifës së parcelës ndërtimore për **11 persona në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në shumën 15,127,616 lekë**, veprime në kundërshtim me nenit 37, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.....”, i ndryshuar, VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe disa komuna”, pikën 1, 2,5 dhe 6, të VKM nr. 870, datë 27.12.2006, si dhe pika 4,3, të nenit 4, të VKM nr. 1180, datë 5.8.2008.

c) Për shkelje, të meta e mangësi, të konstatuara në **8 raste** për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej **1102.71 m²** të papaguar në vlerë **4,617,828 lekë**, në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, si diferencë ndërmjet sipërfaqes së miratuar në VKM-të përkatëse dhe sipërfaqes së legalizuar (me leje legalizimi), veprime në kundërshtim me nenet 17 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”, VKM, nr. 1180, datë 5.8.2008, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimit e të ardhurave të procesit të legalizimit” të ndryshuar, me VKM nr. 870 datë 27.12.2006 “Për metodologjinë e llogaritjes së vlerës së parcelës ndërtimore”, kreun II, pikën 11 të VKM nr. 437, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”.

d) Për shkelje, të meta e mangësi, në mos zbatimin e procedurave ligjore për vendosjen e penaliteteve të **35 personave në shumën 141,191 lekë**, në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, ku vetëdeklarimet janë në kundërshtim me nenin 7, pika 2, e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

e) Për shkelje, të meta e mangësi, të konstatuara në **2 raste** për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej **730 m²** të papaguar në vlerë **6,064,800 lekë**, si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore të konstatuar ndërmjet sipërfaqes së legalizuar (me leje legalizimi) dhe sipërfaqes së parcelën ndërtimore të zaptuar në fakt nga poseduesi, e cila duhet shitur me vlerën e tregut, **duke i shkaktuar një të ardhur të munguar në buxhetit të shtetit për fondin e kompensimit të ish pronarëve**, veprime në kundërshtim me nenet 17 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“.

I/B “Vërejte me paralajmërim për Zgjidhjen e kontratës së punës”.

- 1. Zj. E.E.** me detyrë përgjegjëse e sektorit hartograf
- 2. z. M.I.** me detyrë përgjegjëse e sektorit regjistrim fillestar.
- 3. znj. E.F.** me detyrë juriste.

- Për mos hartimin e rregullores për funksionimin e institucionit, ndarjen e detyrave për çdo sektor dhe për punonjës të meta e mangësi, në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 515, datë 13.05.2009 “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të Qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informate”, VKM nr. 289, datë 17.05.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së legalizimit, urbanizimit dhe integritit të zonave/ndërtimeve informale (ALUIZNI), të ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 82, datë 03.05.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së degëve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe integritit të Zonave/ndërtimeve Informale” dhe shkresës nr. 62/19, datë 16.01.2008 të Drejtorit të Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë.

II. Për punonjësit e Drejtorisë Qendrore të ALUIZNIT Tiranë:

II/A “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontratë pune”

- 1- **Znj. T.K.**, me detyrë P/Sektorit të Legalizimit;
- 2- **Znj. I.P.**, me detyrë P/Sektorit të Urbanizimit;
- 3- **Z. E.LI.**, me detyrë ish-Specialist Legalizimi;
- 4- **Z. E.C.**, me detyrë ish-specialist kompensimit të ish-pronarëve;
- 5- **Znj. L.O.**, me detyrë ish-Specialit Legalizimi;

a) Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimeve, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe certifikimin të objektit informal (leje legalizimi), në zbatim të pikës 4, të VKM nr. 411, datë 19.05.2010 “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”, si në;

- **8 raste**, në zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të Bashkisë Durrës;

- **20 raste**, në zonat brenda ose pranë vijës së ndërtimit të strukturës së rrugës, në Studim Urbanistik të Zonës së Plazhit Durrës me kondicionet urbanistike të tij (rrugët, lartësitë dhe distancat midis objekteve) dhe kanalet kullues;

veprime në kundërshtim me nenin 2 dhe 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, pikën 2, germa “a”, “b” dhe “dh”, të VKM-së nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, të nenit 29, të ligjit nr. 9048 datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, të neni 2 dhe 3, të VKM-së nr. 237, datë 23.03.2011 “Për miratimin e rregullores, për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit.

b) Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen e vlerave të tarifës së parcelës ndërtimore për **1 persona në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në shumën 556,800 lekë**, veprime në kundërshtim me nenit 37, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.....”, i ndryshuar, VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë bashkitë dhe disa komuna”, pikën 1, 2,5 dhe 6, të VKM nr. 870, datë 27.12.2006, si dhe pika 4,3, të nenit 4, të VKM nr. 1180, datë 5.8.2008.

c) Për shkelje, të meta e mangësi, të konstatuara në **8 raste** për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej **1102.⁷¹ m²** të papaguar në vlerë **4,617,828 lekë**, **në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik**, si diferencë ndërmjet sipërfaqes së miratuar në VKM-të përkatëse dhe sipërfaqes së legalizuar (me leje legalizimi), veprime në kundërshtim me nenet 17 dhe 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”, VKM, nr. 1180, datë 5.8.2008, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” të ndryshuar, me VKM nr. 870 datë 27.12.2006 “Për metodologjinë e llogaritjes së vlerës së parcelës ndërtimore”, kreun II, pikën 11 të VKM nr. 437, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”.

III. Për të meta dhe mangësitë e konstatuara dhe të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për ish-punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Aluiznit Durrës: *F.Ç., S.D., A.M., F.Y.*,

M.K. dhe A.M. dhe Drejtorisë Qendrore të Aluiznit Tiranë: z. A.B., dhënia e masave disiplinore quhet e zauruar. Këta punonjës kanë një periudhë kohore mbi 6 muaj që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Durrës, në zbatim të kontratave individuale të lidhura sipas Kodit të Punës, dhe shkeljet e konstatuara janë të nivelit të dhënies së masave disiplinore **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për të cilën i lihet detyrë që të informojë Departamentin e Administratës Publike për masën e këtyre personave.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 805/14, datë 14.4.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durres:

1. Z. A.L., me detyrë ish-Drejtor i ALUZNIT Durrës;
2. Z. E.J., me detyrë ish-Drejtor i Aluznit Durrës;
3. Z. K.K., me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim ;
4. Znj. A.L., me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim ;
5. Z. P.I., me detyrë ish-P/Sektorit të Legalizim e Urbanizim;
6. Z. F.C., me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit Fillestar;

Nga ALUIZNI Durres, me shkresë protokolluar në KLSH me nr. 805/25 datë 15.5.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **ku rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar po pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Ramadan Zejnuni, Halil Isufi, Qemal Shehu, Hysen Metko, Kristaq Gjurgjaj dhe Skender Muca, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT